



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 156, Datë 07.10.2020

“MBI

PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN SHTATOR 2020”.

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 87 pika 4, të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes të energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 201, datë 04.12.2017 i ndryshuar; nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr.96, datë 03.09.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, (ERE) në mbledhjen e tij të datës 07.10.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur me nr.105/3 prot datë 02/10/2020 nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes të energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit” për muajin shtator 2020,

Konstatoi se:

- Shoqëria FSHU sh.a. me shkresën e saj nr. 8326 Prot, datë 25.09.2020, ka paraqitur në ERE aplikimin për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për muajin shtator 2020, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të cilët furnizohen nga Furnizuesi i mundësisë së fundit.
- Energjia e blerë në tregun e parregulluar për plotësimin e nevojave për mbulimin e kërkesës për furnizimin e klientëve FMF është në sasinë mesatare të ponderuar prej 203,170 MWh dhe në vlerën mesatare të ponderuar prej 1,532,015,552 lekë ose 7.320 lekë/kWh.
- FTL sh.a. ka realizuar dy procedura blerje të energjisë elektrike, respektivisht për plotësimin e nevojave të "Operatori i sistemit të shpërndarjes" sh.a. dhe "Furnizuesi i shërbimit universal" sh.a.
- Bazuar në kërkesën e shoqërisë FSHU sh.a., Kostot Administrative të Furnizuesit të mundësisë së fundit për vitin 2020, janë vlerësuar sa ato të vitit 2019.
- **Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit:** bazuar në vendimin nr. 198, datë 12.12.2019, “Mbi lënien në fuqi të vendimit nr. 266, datë 21.12.2018, të bordit të ERE, në lidhje me tarifën e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2020”, është 0.75 lekë/kWh.
- **Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV:** bazuar në vendimin Nr. 199, datë 12.12.2019, të bordit të ERE “Mbi shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit të ERE nr. 268, datë 21.12.2018, për tarifën e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes sipas nivelit të tensionit për vitin 2020”, është 1.5 lekë/kWh.

- Në zbatim të “Metodologjisë të përcaktimit të çmimit të shitjes të energjisë elektrike nga Furnizuesi i mundësisë së fundit” të rishikuar, llogaritjet e FSHU sh.a. si dhe përlllogaritjet e ERE-s për përcaktimin e çmimit për klientët që furnizohen nga FMF për muajin shtator 2020, paraqiten në tabelën përmbledhëse si vijon:

		<i>Çmimi i FMF-së për muajin Shtator 2020</i>		
Shtator 2020			Aplikimi FSHU sh.a.	Përlllogaritjet e ERE
		Njësia	Çmimi	Çmimi
CBEt	Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes në treg të parregulluar ose blerja nga prodhuesit me përparësi	Leke/kWh	7.320	7.487
Pr	<u>Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)</u>	<u>Leke/kWh</u>	<u>0.22</u>	<u>0.22</u>
Çmimi mesatar i blerjes ne periudhen relevante		Leke/kWh	7.54	7.71
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Leke/kWh	1.79	1.79
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Leke/kWh	0.75	0.75
TSHt	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Leke/kWh	1.50	1.50
Çmimi i energjisë = CBEt +Pr* CBEt+ TRrTSHt+CA		Leke/kWh	11.58	11.75

- Për sa përcaktuar për çdo element të formulës përlllogaritëse, bazuar në informacionet e paraqitura në këtë aplikim, informacionit të përcjellë nga FTL sh.a. si dhe vlerësimeve të ERE sa më sipër, rezulton se çmimi i shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin **shtator 2020**, të jetë **11.75 Lekë/kWh**.

Për gjithë sa më sipër cituar bordi i ERE-s,

Vendosi:

- Miratimin e çmimit të shitjes të energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit prej 11.75 Lekë/kWh për muajin shtator 2020.
- Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarëveshjeve, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI